

## KESHILLI I BASHKISE KORCE

---

### VENDIM

Nr. 56, Dt. 19/7 / 2007

### MBI REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 35, DT. 07.05.2001, TE KESHILLIT BASHKIAK KORCE DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SE RE TE QARKULLIMIT TE AUTOMJETEVE DHE MJETEVE TE TJERA NE QYTETIN E KORCES

Keshilli i Bashkise Korce ne mbledhjen e tij te dates se sotme pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, Drejtoria e Puneve Publike dhe Drejtoria e te Ardhurave "Mbi revokimin e vendimit nr. 35, dt. 07.05.2001, te Keshillit Bashkiak Korce dhe miratimin e rregullores te re te qarkullimit te automjeteve dhe mjeteve te tjera ne qytetin e Korces", bazuar ne Ligjin 8485, dt. 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise" neni 124, Ligjin Nr 8308, date 18.03.1998, "Per Transportet Rrugore" neni 22, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8908, dt 06.06.2002, Ligjin Nr.9096, date 03.07.2003, Ligjin Nr. 9373, dt. 14.04.2005, neni 3, Ligjin Nr. 8378, dt. 22.07.1998, "Kodi rrugor i Republikes se Shqiperise", neni 2 dhe neni 7, Ligjin Nr. 8652, dt. 31.07.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32:

#### VENDOSI :

1. Te revokoje vendimin nr. 35, dt. 07.05.2001, te Keshillit Bashkiak Korce "Mbi miratimin e rregullores te qarkullimit te automjeteve dhe mjeteve te tjera ne qytetin e Korces".
2. Te miratoje rregulloren e re te qarkullimit te automjeteve dhe mjeteve te tjera ne qytetin e Korces" (bashkelidhur ketij vendimi).
3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Puneve Publike, Drejtoria e te Ardhurave dhe Drejtoria e Policise Bashkiake.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.



**Raimonda NASE**

KRYETAR

## **RREGULLORJA E QARKULLIMIT TE AUTOMJETEVE DHE MJETEVE TE TJERA NE QYTETIN E KORCES**

1. Ndalohet qarkullimi i mjeteve te terhequra me kafshe te destinuar per transport mallrash (karroca) ne rruget brenda unazes se qytetit, duke perjashtuar vetem rruget “Ajet Gjindolli”, “Viktimat e 7 shkurtit” dhe tregun e shumices. Ndersa per mjetet e terhequra me kafshe te destinuar per transport njerezish (pajtonët), levizja e tyre ne qytet te kryhet sipas nje autorizimi ku te percaktohen orari, ditet dhe rruget ku mund te qarkullojnë’.

2. Ndalohet qarkullimi i automjeteve me mase maksimale te autorizuar mbi 3.5 T ne rruget brenda unazes se qytetit, duke perjashtuar vetem rruget “Ajet Gjindolli”, “Viktimat e 7 shkurtit” dhe tregun e shumices ne qytet.

3. Automjetet me mase maksimale te autorizuar mbi 3.5 T te pajisen me autorizim prej Drejtorise perkatese ne Bashki, per te qarkulluar ne rruget e qytetit. Ne kete autorizim te percaktohen rruget dhe orari i levizjes, duke gjykuar sipas kerkeses dhe arsyeve te subjektit qe disponon automjetin

4. Ndalohet qarkullimi i automjeteve ne Bul. “Republika” dhe Bul. “Rilindasit” ne orarin 18.00 – 22.00 per periudhen prej 15 majit – 15 shtator , duke perjashtuar rastet kur ne rruget prane ketyre bulevardeve eshte i pamundur qarkullimi normal i automjeteve.

5. Si vendparkime publike me pagese ne qytet jane :

- Vendparkimet prane sheshit tek Teatri ‘A.Z.Cajupi’
- Vendparkimet prane sheshit tek Kinema ‘Millenium’.
- Vendparkimet prane pazarit te qytetit.

6. Kerkesat per parkim te rezervuar te shqyrtohen ne bashkepunim ndermjet Drejtorive te Urbanistikes, Drejtorise te Puneve Publike dhe Drejtorise se te Ardhurave. Miratimi i tyre te jete kundrejt pageses se tarifes se parkimit.

7. Qarkullimi i autobuseve te linjave rrethqytetese dhe nderqytetese te kryhet vetem ne unazen e qytetit dhe ne rrugen “Kico Greco” me destinacion stacionin aktual, duke perjashtuar autobuset e linjes Korce – Maliq – Korce te cilet qarkullojne edhe ne rrugen ‘Midhi Kostani’ me destinacion stacionin e mberritjes.

8. Autobuset te cilet kryejne transportin e mesuesve, nxenesve si dhe punonjesve te subjekteve private te pajisen me autorizim, ne te cilin percaktohen oraret, itinerari dhe vendet e qendrimit ne qytet. Dhenia e ketyre autorizimeve te behet ne bashkepunim me Policine e Qarkullimit Rrugor. Lejohet qarkullimi ne qytet i autobuseve te cilet kryejne transportin e udhetareve per qellime turistike.

9. Stacioni i nisjes dhe mberritjes se autobuseve te linjave rrethqytetese dhe nderqytetese eshte stacioni aktual (prane nderprerjes te rrugeve “Kico Greco” me “Edit Durham”), duke perjashtuar autobuset e linjes rrethqytetese Korce – Maliq – Korce, per te cilen vendi i mberritjes eshte rruga “Midhi Kostani” dhe vendi i nisjes rruga “Kico Greco”, dhe autobuset e linjes Korce – Pogradec per te cilet mund te perdoret si vendnisje, prane hyrjes te ish-Fabrikës se Lekures (para stacionit te Maliqit).

10. Koha e qendrimit te autobuseve ne stacion te jete vetem 30 min. para orarit te nisjes.

11. Qarkullimi i autobuseve te subjekteve te transportit nderkombetar te udhetareve brenda rrugeve te unazes se qytetit te kryhet sipas nje autorizimi, ne te cilin te percaktohet itinerari dhe oraret e levizjes.


Kerkesat per stacione nisje te autobuseve te subjekteve te transportit nderkombetar te shqyrtohen ne bashkepunim ndermjet Drejtorise te Urbanistikes, Drejtorise te Puneve Publike dhe Drejtorise se te Ardhurave, duke marre parasysh edhe mendimin e perfaqesuesve te Sektorit te Policise se Qarkullimit Rrugor.

12. Vendqendrimet e automjeteve taksi me (4+1) vende ne qytetin e Korces jane:

1. Ne rrugen ‘Edit Durham’. (14 vende parkimi).
2. Para hyrjes se stadiumit. (7 vende parkimi).
3. Ne nderprerjen e rruges ‘Todi Vogli’ me rrugen ‘Partizani’ (4 vende parkimi).

4. Para hyrjes te spitalit te qytetit. (7 vende parkimi).
  5. Prane nderprerjes se rruges '28 Nentori' me unazen e qytetit. (rruga e Ersekës). (4 vende parkimi).
  6. Ne shetitore 'Fan Noli' (prane poliklinikes se qytetit) (6 vende parkimi).
  7. Perballe Kinema 'Millenium'(4 vende parkimi).
  8. Prane kryqezimit te rruges '28 Nentori' me shetitore 'Fan Noli' (prane Alpha Bank) (3 vende parkimi).
  9. Prane kryqezimit te rruges '10 Korriku' me rrugen 'Viktor Eftimiu'(4 vende parkimi).
  10. Prane kryqezimit te rruges 'Ajet Gjindolli' me rrugen 'Viktimat e 7 Shkurtit' (3 vende parkimi).
  11. Ne rrugen 'Kico Greco' (prane ish- U.M.B.-se Korce) (5 vende parkimi).
  12. Ne Lagjen e Re (prane Drejtorise Rajonale te Rrugeve) (4 vende parkimi).
  13. Prane 'ESSE GRUP'. (ne orarin 20.00 – 06.00) (3 vende parkimi).
  14. Ne rrugen 'Midhi Kostani' (perballe B.K.T. –se) (6 vende parkimi).
- Tre prej te cilave per automjetet e sherbimit Radio-Taksi.
15. Ne rrugen 'Todi Vogli' (prane hyrjes se urgjences te spitalit) (3 vende parkimi).

Miratuar ne Vendimin nr. 56, dt 19.7.2017 te Keshillit Bashkiak te qytetit te Korces.



**Raimonda NASE**  
KRYETAR I KESHILLIT